VENDIM
Nr. 14, datë 11.1 1993

PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË POSTAVE DHE TELEKOMUNIKACIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Financave e të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Transporteve e Komunikacioneve, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Tarifat e shërbimeve të postave dhe telekomunikacioneve rriten mesatarisht ndaj atyre ekzistuese në këta kufij:

	Rritja mesatare në herë për:	
	Popullin	**Përdoruesit e tjerë**
a) Tarifate shërbimeve postare	4.5	Nuk rriten
b) Tarifate e shërbimeve të telekomunikacioneve	25	2.5

2. Ministria e Transporteve dhe Komunikacioneve dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë përcaktojnë tarifat e shërbimeve të postave dhe telekomunikacioneve mbi bazën e rritjes së tarifave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

Tarifat për shërbimet ndërkombëtare të postave dhe telekomunikacioneve të përcaktohen në valutë dhe konvertimi në lekë për efekt pagese bëhet në bazë të kursit mesatar të këmbimit të bankës, por jo më shpesh se një herë në tre muaj.

3. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Transporteve dhe Komunikacioneve të nxjerrin udhëzimet përaktëse për zbatimin e këtij vendimi.

4. Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 shkurt 1993.

ZV. KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku